METAMORPHOSIS
Foundation for Internet and Society

Фондација Метаморфозис - Скопје
Foundation Metamorphosis - Skopje
Бр. 01-85/3
31.12 2018 год.
СКОПЈЕ

Политика на интегритет

Potitika e integritetit

Bazuar në Kodin e sjelljes në "Metamorfozis". Udhëheqësia e Fondacionit miratoi politikën e integritetit e cila bazohet në parimet në vijim:

INTEGRITETI

1. Jofitimprurëse

a. JO-PËR-FITIM

Fondacioni "Metamorfozis" është i organizuar dhe punon si organizatë jofitimprurëse. Çdo përfitim që del nga puna e organizatës do të përdoret vetëm për të ndihmuar Fondacionin në realizimin e misionit dhe qëllimeve. Asnjë pjesë e neto përfitimeve të Fondacionit nuk do të përdoren për përfitime të anëtarëve të Bordit Drejtues, drejtorëve, anëtarëve ose të punësuarve në Fondacion, apo ndonjë personi tejtër privat. Megjithatë, përfitime të tilla mund të përdoren për kompenzim të shërbimeve që i jepen Fondacionit.

b. TREGTI APO BIZNES

Qëllimi primar i Fondacionit "Metamorfozis" nuk është udhëheqja e tregtisë ose biznesit, që nuk ndërlidhen me misionin dhe qëllimet e përcaktuara.

c. INSTRUMENT I QEVERISJES

Bordi Drejtues i "Metamorfozis" do ta pengojë Fondacionin në distribuimin e përfitimeve ose të ardhurave për përfitim të individeve edhe gjatë kohës së funksionimit, edhe pas mbylljes.

2. Joqeveritare

a. JOQEVERITARE

Fondacioni “Metamorfozis” nuk është pjesë, as kontrollohet, nga Qeveria ose ndonjë agjencion ndërqeveritarë.

b. POLITIKISHT E PAVARUR

Si organizatë joqeveritare apartiake, Fondacioni “Metamorfozis”, do të ruaj pavarësinë dhe nuk do të bashkëveprojë ose bashkohet me cilëndo qoftë parti politike, por mund të mbështes kauzë të përbashkëta politike apo ligjore në kuadër të kufijve të misionit të Fondacionit, qëllimeve të potencuara dhe strukturës jurkdike.

Tentimet për përfaqësim në “Metamorfozis”, mund të përfshijnë aktivitete apartiake të lidhura me zgjedhjet. Por, resurset e saj nuk mund të përdoren për mbështetje të aktiviteteve politike dhe partiake, duke përfshirë edhe mbështetje ose përballje me partitë ose organizatat politike dhe mbështetje ose përballje me kandidatët për funksione publike.

c. POLITIKA E JASHTME

Fondacioni “Metamorfozis” nuk do të veprojë si instrument i politikës së jashtme qeveritare, por do të veprojë i pavarur nga qeveritë. Fondacioni nuk do të ketë qëllim të realizojë politika të cilësdo Qeveri, përveç nëse e njejta nuk përshtatet me misionin e Fondacionit ose me politiken e pavarur të Fondacionit.

3. I organizuar

“Metamorfozis” i realizon aktivitetet në përputhje me statutin e përcaktuar, këtë dokument dhe kornizat ligjore dhe institucionale të Maqedonisë dhe vendeve ku vepron.

2. Dokumente të organizatës:

- Misioni
- Statuti i Fondacionit “Metamorfozis” (akte nënligjore)
- Struktura organizative e Fondacionit

3. Njohjet ligjore

“Metamoefozis” është organizatë joqeveritare- Fondacion, është i regjistruar sipas Ligjit për shoqata dhe fondacione të Republikës së Maqedonisë.

4. I pavarur dhe gëzon autonomi në udhëheqje

a. I PAVARUR

Fondacioni “ Metamorfozis” është i pavarur. Politika, vizioni dhe aktivitetet nuk janë miratuar nga asnjë koorporatë fitimprurëse, donatorë, Qeveri, funksionarë qeveritar, parti politike ose organizatë tjetër joqeveritare.

b. UDHËHEQJE AUTONOME

Fondacioni “Metamrofozis” është autonom në veprimtarinë e tij në bazë të Statutit dhe është i pajisur për kontrollim të aktiviteteve të veta.

5. Aksione vullnetare

KONTRIBUTE NGA VULLNETARËT

Për ta realizuar misionin dhe qëllimet, Fondacioni do të pranon kontribut të theksuar nga vullnetarët. Këtu mund të jenë pjesë grupacione me interest të përbashkët dhe përkrahësit.